

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimit publike ishte 20 ditë pune, duke filluar nga data 20 qershor 2024 deri më 18 korrik 2024.

3. Metoda e konsultimit

1. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
2. Konsultime të Grupit të Punës

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara që kanë dhënë komente në konsultimet publike:

Nuk ka patur reagim nga palë të interesuara gjatë konsultimit publik në RENJKP.

Palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për shqyrtimin e kuadrit ligjor ekzistues për çështjet e diasporës:

1. Zëvendësministri që mbulon çështjet e diasporës, Kryetar;
2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Politike dhe Strategjike, anëtar;
3. Drejtori i Drejtorisë së Diplomacisë Publike dhe Diasporës;
4. Drejtori i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinje, anëtar;
5. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar;
6. Drejtori/Përgjegjësi i Sektorit i Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve, anëtar;
7. Drejtori/Përgjegjësi i Sektorit i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, anëtar;
8. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, anëtar;
9. Drejtori i Qendrës së Studimeve Arbëreshe, anëtar;
10. Specialisti i Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve, sekretar.

Në mbledhje të GP kanë marrë pjesë dhe përfaqësues nga:

11. Dhoma e Biznesit të Diasporës,
12. Qendra e Botimeve të Diasporës,
13. Këshilli Kombëtar i Diasporës (pjesëmarrje online),
14. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Albania).

Këshilli Kombëtar i Diasporës dhe Qendra e Botimeve të Diasporës e kanë mbështetur shfuqizimin e nenit 22 (Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës) të ligjit nr.16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar, dhe për rrjedhojë shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
--	--	---	---	-------------

<i>e..., rregullimi i..., etj.)</i>		<i>që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>		